



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 09.03.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 05.02.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INTEGRAL SHPK&Milenum Construction" për aktivitetin :"**Vazhdimi i rruges B-pjesa e dyte**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1015-511 nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet ankesa e Operatorit Ekonomik "INTEGRAL SHPK&Milenum Construction" e datës 06.03.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Vazhdimi i rruges B-pjesa e dyte**" me numër të prokurimit: 616 -19-1015-511, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së , të datës 04.03.2020 të publikuar në Platformën e KRPP-se-E Prokurimi.
2. Pezullohet Njoftimi i Vendimit për dhënie të kontratës i publikuar me datë: 04.03.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *aktivitetin ta kthejë në rivleresim*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Integral SHPK&Milenum Konstruction**" me datë 06.03.2020 ka parashtruar kerkesën për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Vazhdimi i rruges B-pjesa e dyte**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1015-511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 06.03.2020 dhe 09.03.2020, ka shqyrtuar kerkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Pretendimi kryesor është se Autoriteti Kontraktues nuk ka vlerësuar si duhet deshmite e ofruara për kryerjen e punëve të ngjajshme duke mos analizuar disa kontrata që kanë emertimin si mirembajtje e rrugëve, mirepo në kuader të tyre ka shumë punime të ngjajshme si që janë kërkuar në këto aktivitete. Pretenduesi lidhur me këto ka ofruar deshmite e punimeve të kontraktuara dhe të realizuara në kuader të të njëjtave kontrata ku ka pozicione që janë të njëjta

me pozicionet e punimeve te paraqitura ne pershkrimin e çmimit te Autoritetit Kontraktues. Vlen te theksohet se keto deshmi kane qene pjese e tenderit te dorzuar, por nuk jane analizuar nga komisioni i vleresimit.

Bazuar ne pretendimin e te njejtit Zyrtari pergjegjes i prokurimit ka analizuar deshmite e ofruara me kerkesen per rishqyrtim dhe deshmite e dorezuara me tenderin e tij dhe ka konstatuar si vijon:

-Ne listen e kontratave grupi i OE-ik ka paraqitur kontrata per ndertim te rrugeve ne vlere mbi 2.000.000,00 euro dhe poashtu ka paraqitur disa kontrata per mirembajtje te rrugeve ne kuader te te cilave ka mjaft punime si ne projektin ku ka konkuruar.

Bazuar ne kete konstatoj se komisioni i vleresimit nuk ka analizuar te gjitha deshmite e ofruara nga ky grup i OE-ik dhe pa te drejte ka refuzuar tenderin me arsyetimin se nuk ka referenca ne vleren e kerkuar ne dosjen e tenderit.

Sa i perket pretendimit lidhur me licencen e gurethyesit ne kete rast nuk mund te jap vleresim perfundimtar, pasi qe ne dokumentet e disa tenderueseve shkruan licence per shfrytezim, ndersa te disa tjere licence per hulumtim, por kjo duhet te definohet nga komisioni i rivleresimit dhe eventualisht te kerkohet sqarim nga Organi kompetent per dhenjen e ketyre licencave.

Ne baze te ketyre konstatimeve kam vendosur qe lenda te kthehet ne rivleresim dhe te shqyrtohen me kujdes te gjitha deshmite e dorezuara nga ky tenderues dhe tenderuesit tjere nese tenderet e tyre jane refuzuar sipas te njetit arsytim.

Nga konstatimet paraprake u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

Ne fazen e rivleresimit kerkohet qe te behet vleresim detal i deshmeve dhe dokumentacionit tjeter te te gjitha tenderueseve duke filluar nga tenderi i tenderuesit qe ka parashtruar kerkesen per rishqyrtim.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit